**LIGJ**
**Nr. 55/2016**

# PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË KONCESIONIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE "TIRANA AIRPORT PARTNERS" SHPK, PËR NDËRTIMIN, VËNIEN NË PUNË, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA", TIRANË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9312, DATË 11.11.2004

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesio-nare "Tirana Airport Partners", sh.p.k., për ndër-timin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.5.2016

KRYETARI
**Ilir Meta**

## NDRYSHIMI I MARRËVESHJES SË KONCESIONIT

TË LIDHUR NË DATËN 15 TETOR 2004, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (NDRYSHIMI)

Lidhur më 1.4.2016, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë (Qeveria e Shqipërisë), përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë (së bashku "Organi shtetëror i auto-rizuar"); dhe

2. Tirana International Airport (TIA) sh.p.k. (më parë e njohur si "Tirana Airport Partners" (TAP) sh.p.k.), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila është themeluar dhe ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës nr. 32147, datë 20 shtator 2004, me numër unik identifikimi K51612012D dhe seli të regjistruar në adresën: Ndërtesa e Administratës, Tirana International Airport "Nënë Tereza", Rinas, Shqipëri (Kompania), përfaqësuar nga z. Rolf Castro-Vasquez, në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv dhe drejtorit të përgjithshëm dhe znj. Suela Keri në cilësinë e drejtores së përgjithshme të financës.

Në vijim referuar, gjithashtu, individualisht si "Palë" dhe së bashku si "Palët".

1. Preambulë

Duke qenë se qeveria e Shqipërisë dhe kompania kanë lidhur marrëveshjen fillestare të koncesionit në datën 15 tetor 2004 (Marrëveshja fillestare e koncesionit), e ratifikuar me anë të ligjit nr. 9312, datë 11 nëntor 2004, "Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Tirana International Airport "Nënë Tereza", ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe "Tirana Airport Partners" sh.p.k., si dhe dhënien e disa incentivave të posaçme kompanisë sipas marrëveshjes fillestare të koncesionit" (në vijim referuar si "Ligji i koncesionit të aeroportit").

Duke qenë se data e fillimit, siç është përcaktuar në klauzolën 3.5 (Data e fillimit) e marrëveshjes fillestare të koncesionit është identifikuar si 23 prill 2005.

Duke qenë se qeveria e Shqipërisë dëshiron të nxisë zhvillimin e aviacionit civil në Shqipëri.

Duke qenë se qeveria e Shqipërisë, sipas klauzolës 2.3 (Ekskluziviteti), paragrafi "c" i marrëveshjes

fillestare të koncesionit do të sigurojë se gjatë afatit të koncesionit, asnjë aeroport tjetër për fluturime ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjerë) nuk do të licencohet, autorizohet dhe operohet gjatë afatit të koncesionit në Republikën e Shqipërisë.

Duke qenë se kompania, në varësi të përmbu-shjes së kushteve dhe detyrimeve specifike nga qeveria e Shqipërisë të përcaktuara në këtë ndryshim, ka vullnetin të heqë dorë, në masën e përcaktuar në këtë ndryshim, nga e drejta e ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjerë).

Duke qenë se, të dyja palët kanë autoritetin dhe kompetencat ligjore për të nënshkruar këtë ndryshim, siç është parashikuar në mënyrë specifike në klauzolën 37.7 (Ndryshimet) të marrëveshjes fillestare të koncesionit.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh për sa më sipër, palët bien dakord të ndryshojnë dispozitat e mëposhtme të marrëveshjes fillestare të konce-sionit:

2. Interpretimi

Në këtë ndryshim, të gjithë termat dhe përkufizimet e përdorur, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në formë të shprehur në këtë ndryshim, do të kenë të njëjtin kuptim si termat dhe përkufizimet e përcaktuar dhe interpretuar në marrëveshjen fillestare të koncesionit.

Parimet e interpretimit, të përcaktuara në klauzolën 1.2 (Interpretimi) të marrëveshjes fillestare të koncesionit, do të kenë të njëjtin efekt sikur të ishin përcaktuar në këtë ndryshim.

3. Kushte paraprake

Dispozitat e klauzolës 4 (Ndryshimi) do të jenë efektive vetëm në rast se:

i) Sipas marrëveshjes së amenduar dhe rikonfirmuar të kushteve të përbashkëta, të datës 28 mars 2008, lidhur ndërmjet Alpha Bank – Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., DEG – Deutsche Investitions - Und Entwicklungsgesellschaft MBH dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (së bashku "Huadhënësit kryesorë") dhe kompania, secili nga huadhënësit kryesorë jep miratimin e tij të shkruar për nënshkrimin e këtij ndryshimi nga palët; dhe

ii) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë rati-fikon këtë ndryshim (qeveria e Shqipërisë do të njoftojë kompaninë, e cila më pas do të njoftojë huadhënësit kryesorë, menjëherë pas ratifikimit në fjalë).

4. Ndryshimi

Me efekt duke filluar nga data në të cilën janë plotësuar kushtet paraprake të përcaktuara në klauzolën 3 (Kushtet paraprake), marrëveshja fillestare e koncesionit do të ndryshohet siç është përcaktuar në këtë klauzolë 4.

Dispozitat e marrëveshjes fillestare të konce-sionit, përveç atyre të ndryshuara nga ky ndry-shim, do të vazhdojnë të kenë fuqi dhe efekt të plotë.

4.1 Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme do të përfshihen në klauzolën 1.1 (Përkufizime):

"Aeroporte të përjashtuara", nënkupton Aeroportin e Kukësit dhe Aeroportin e Vlorës.

"Njoftim për zgjatje" do të ketë kuptimin që i është dhënë në klauzolën 2.2 "a" (Kohëzgjatja).

"Aeroporti i Kukësit" nënkupton Aeroportin e Kukësit "Zayed Bin Sultan Al-Nahyan" (Kodi Aeroportual i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil "LAKU") i vendosur në Kukës, Shqipëri.

"Operimi i një aeroporti të ri tregtar" do të ketë kuptimin që i është caktuar në klauzolën 2.2 "a" (Kohëzgjatja).

"Aeroporti i Vlorës" nënkupton bazën ajrore në Vlorë, e vendosur brenda një rrezeje prej 20 km (ajrore) nga qendra e qytetit të Vlorës.

4.2 Afati

Palët bien dakord se fjalia e parë e klauzolës 2.2 (Afati), paragrafi "a", e marrëveshjes fillestare të koncesionit do të fshihet dhe zëvendësohet me për sa më poshtë:

"a) Koncesioni jepet për një afat kohor prej 22 (njëzet e dy) vitesh, duke filluar nga data e fillimit (Afati i koncesionit). Në rast se ndonjë aeroport apo aeroporte, përveç Aeroportit të Kukësit, fillon operimin (për fluturime tregtare (që për këtë qëllim do të thotë data në të cilën kryhet fluturimi i parë tregtar) në Republikën e Shqipërisë përpara datës 23 prill 2025 (operimi i një aeroporti të ri tregtar), afati i koncesionit do të zgjatet si më poshtë (zgjatja e afatit të koncesionit nuk do të tejkalojë limitin maksimal prej 4.5 (katër pikë pesë) vite në total).

Zgjatja e afatit të koncesionit sipas tabelës së mëposhtme do të aplikohet për rastin e parë të operimit të një aeroporti të ri tregtar pavarësisht numrit të aeroporteve të tjera, të cilat mund të fillojnë operimet brenda këtij afati kohor.

| Viti në të cilin aeroporte të tjera vihen në funksion/operim | Zgjatje e afatit të koncesionit në vite |
|---|---|
| 2016 | 4.5 |
| 2017 | 4 |
| 2018 | 3.5 |
| 2019 | 3 |
| 2020 | 2.5 |
| 2021 | 2 |
| 2022 | 1.5 |
| 2023 | 1 |
| 2024 | 0.5 |
| 2025 | 0 |

Palët bien dakord se kompania do të gëzojë të drejtën t'i bëjë të ditur, nëpërmjet një njoftimi në formë të shkruar, Organit Shtetëror të Auto-rizuar (OSHA) në një formë të pranueshme për kompaninë, zgjatjen e afatit të koncesionit në rast të operimit të një aeroporti të ri tregtar (njoftimi për zgjatje). Zgjatja e afatit të koncesionit do të bëhet detyruese dhe efektive me lëshimin e një deklarate të përbashkët njohje të palëve, e cila nuk do të vonohet pa arsye nga OSHA-ja (në çdo rast jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga njoftimi për zgjatje). Në rast se deklarata e përbashkët nuk lëshohet brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi për zgjatje, vetë ky njoftim për zgjatje do të jetë detyrues për palët dhe i mjaftueshëm për zgjatjen e afatit të konce-sionit.

Për shmangie të çdo dyshimi, pavarësisht muajit të vitit përkatës në të cilin ka ndodhur operimi i një aeroporti të ri tregtar, palët bien dakord që operimi i aeroportit të ri tregtar do të konsiderohet të ketë filluar në datën 1 janar të vitit përkatës.".

Për shmangie të çdo dyshimi, çdo operim i një aeroporti të ri tregtar duhet të jetë konsistent me kufizimet e ekskluzivitetit të përcaktuara në klauzolën 2.3 (Ekskluziviteti) të marrëveshjes fillestare të koncesionit të ndryshuar nga ky ndryshim.

Për shmangie të çdo dyshimi, paragrafi "b" dhe të gjitha fjalitë e tjera të paragrafit "a" të klauzolës 2.2. (Afati) të marrëveshjes fillestare të koncesionit do të mbeten të paprekura dhe të pandryshuara.

Referencat në paragrafin hyrës "C", klauzolën 3.2 "b" (iv), klauzolën 3.2 "d" të marrëveshjes fillestare të koncesionit, për afatin kohor prej 20 (njëzet) vitesh do të konsiderohen të zëvendësuar nga afati kohor prej 22 (njëzet e dy) vitesh.

4.3 Ekskluziviteti

Palët bien dakord se klauzola 2.3 (Eksklu-ziviteti), paragrafi "c", i marrëveshjes fillestare të koncesionit do të fshihet dhe do të zëvendësohet me për sa më poshtë:

"c) Qeveria e Shqipërisë do të sigurojë se gjatë afatit të koncesionit, përveç aeroporteve të përjashtuara, nuk do të licencohet, autorizohet dhe as operohet aeroport tjetër, për fluturime ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjerë), në një rreze prej 100 km (ajrore) nga Tirana International Airport "Nënë Tereza", me përjashtim të uljeve emergjente. Asnjë kusht i kësaj kontrate nuk do të kufizojë përdorimin e ndonjë aeroporti në Republikën e Shqipërisë për qëllime të ndihmave humanitare ose të ndihmave emergjente në kohë katastrofash ose emergjen-cash civile në Republikën e Shqipërisë ose në territoret fqinje.".

Për shmangie të çdo dyshimi, të gjithë paragrafët e tjerë në klauzolën 2.3 (Ekskluziviteti) të marrëveshjes fillestare të koncesionit do të mbeten të paprekur dhe të pandryshuar.

4.4 Detyrimet e qeverisë së Shqipërisë

Palët bien dakord se në klauzolën 5.2 (Detyrimet e qeverisë së Shqipërisë), paragrafi "v", i marrëveshjes fillestare të koncesionit do të fshihet dhe do të zëvendësohet për sa më poshtë:

"v) Të sigurojë se gjatë afatit të koncesionit, përveç aeroporteve të përjashtuara, nuk do të licencohet, autorizohet dhe as operohet aeroport tjetër, për fluturime ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjerë), në një rreze prej 100 km (ajrore) nga Tirana International Airport "Nënë Tereza", me përjashtim të uljeve emergjente. Për shmangie të çdo dyshimi, asnjë kusht i kësaj kontrate nuk do të kufizojë përdorimin e ndonjë aeroporti në Republikën e Shqipërisë për qëllime të ndihmave humanitare ose të ndihmave emergjente në kohë katastrofash ose emergjen-cash civile në Republikën e Shqipërisë ose në territoret fqinje; dhe".

Palët bien dakord që në klauzolën 5.2 (Dety-rimet e qeverisë së Shqipërisë) të marrë-veshjes fillestare të koncesionit do të shtohet një paragraf tjetër me shkronjën "w", i cili do të lexohet si më poshtë:

"w) Të sigurojë që në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Bashkimit Evropian "Mbi ndihmën shtetërore për aeroportet dhe shoqëritë ajrore (2014/C/99/03" dhe ligjit nr. 9658, datë 18.12.2006, qeveria e Shqipërisë, përpara dhënies së investimeve apo ndihmës operacionale ndaj aeroporteve të

tjera, do të njoftojë kompaninë, në formë të shkruar, në lidhje me nevojën për këto masa ndihmëse kundrejt një aeroporti tjetër, duke e informuar kompaninë në lidhje me perspektivat afatmesme për përdorimin e aero-portit tjetër, natyrën, proporcionalitetin dhe përllogaritjen e masave ndihmëse të parashikuara, si dhe efektin e mundshëm në përdorimin e infrastrukturës ekzistuese të Kompanisë.".

Për shmangie të çdo dyshimi, të gjithë paragrafët e tjerë në klauzolën 5.2 (Detyrimet e qeverisë së Shqipërisë) të marrëveshjes fillestare të koncesionit do të mbeten të paprekura dhe të pandryshuara.

5. Dispozita të ndryshme

5.1 Tërësia e kontratës

Ky ndryshim, duke përfshirë preambulën e tij, përcakton të gjithë marrëveshjen ndërmjet palëve në lidhje me objektin e tij dhe mbizotëron çdo marrëveshje apo mirëkuptim të mëparshëm të shkruar apo verbal, si dhe çdo mirëkuptim apo marrëveshje aktuale verbale ndërmjet palëve në lidhje me këtë objekt. Ai përbën shprehjen e mirëkuptimit përfundimtar, të plotë dhe eksk-luziv të palëve në lidhje me çështjet e përshkru-ara në këtë dokument. Palët pranojnë se për lidhjen e këtij ndryshimi nuk janë bazuar në asnjë deklaratë apo garanci tjetër përveç atyre të shprehura në këtë ndryshim.

5.2. Garancia e qeverisë së Shqipërisë

Qeveria e Shqipërisë garanton dhe siguron në formë të shprehur se përveç ndryshimeve të përcaktuara në klauzolën 4 (Ndryshimi) të mësipërme, asnjë e/të drejtë/a (te) tjetër/a (e përfshirë në marrëveshjen fillestare të konce-sionit), përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në formë të shprehur në këtë ndryshim, të dhëna në mënyrë të vetme dhe ekskluzive kompanisë nga qeveria e Shqipërisë, nuk do të preket/n.

5.3 Inkorporimi i kushteve

Dispozitat e klauzolës 37.2 (Njoftimet), klau-zolës 37.3 (Heqja dorë) dhe secila nga klauzolat 37.7 (Ndryshimet) deri në 37.17 (Përgjegjësi individuale e ortakëve), përfshirë marrëveshjen fillestare të koncesionit do të inkorporohen në këtë ndryshim, sikur të ishin përcaktuar të plota në këtë ndryshim dhe sikur referencat në këto klauzola ndaj "kësaj Marrëveshjeje" të ishin referenca ndaj këtij ndryshimi.

5.4 Pavarësia e dispozitave

Në rast se ndonjë dispozitë e këtij ndryshimi anulohet, bëhet e paligjshme ose e pazbatueshme sipas një juridiksioni të caktuar, ky anulim, paligjshmëri ose pazbatueshmëri nuk do të prekë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të këtij ndry-shimi ose të ndikojë në vlefshmërinë, ligjsh-mërinë apo zbatueshmërinë e dispozitave në çdo juridiksion tjetër.

5.5 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord se në rast të një mosmarrë-veshjeje apo pretendimi, i cili lind si rezultat apo në lidhje me këtë ndryshim, klauzola 36 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) e marrëveshjes fillestare të koncesionit do të aplikohet, *mutatis mutandis*.

5.6 Legjislacioni i aplikueshëm

Ky ndryshim dhe çdo detyrim jokontraktual, i cili mund të lindë nga/apo në lidhje me këtë ndryshim do të rregullohet sipas ligjit anglez.

5.7 Gjuha

Ky ndryshim do të firmoset në gjuhën shqipe me përkthimin e sigluar në gjuhën angleze bashkëngjitur si një pjesë integrale e tij. Në rast mospërputhjeje ndërmjet përkthimit të ndryshi-mit në gjuhën angleze të sigluar dhe tekstit shqip të këtij ndryshimi, përkthimi anglisht i këtij ndryshimi do të mbizotërojë. Çdo dokument i përmendur në këtë ndryshim ose që duhet të dorëzohet sipas këtij ndryshimi do të jetë në gjuhën angleze dhe/ose në gjuhën shqipe, sipas nevojës.

5.8 Kopjet

Ky ndryshim do të nënshkruhet në pesëmbë-dhjetë kopje të njëjta dhe të gjitha së bashku do të konsiderohen të përbëjnë një dhe të njëjtin dokument.

6. Nënshkrimi

Palët nënshkruajnë këtë ndryshim në datën 1.4.2016.

**Për dhe në emër të:**
**Tirana International Airport sh.p.k.**

_____
Nënshkrimi:

Rolf Castro-Vasquez
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Drejtor i Përgjithshëm

_____
Nënshkrimi:

Suela Keri
Drejtore e Përgjithshme e Financës

**Për dhe në emër të :**
**Qeverisë së Shqipërisë**

**Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës**

_____
Nënshkrimi:

Edmond Haxhinasto
Ministër

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**

_____
Nënshkrimi:

Milva Ekonomi
Ministër